REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E ARTIT, KULTURËS DHE TURIZMIT

THIRRJE PUBLIKE

PËR PROJEKTE ARTISTIKE DHE KULTURORE NË KUADËR TË KALENDARIT ARTISTIK DHE KULTUROR TË BASHKISË FIER PËR VITIN 2027

Bashkia Fier, nëpërmjet Drejtorisë së Artit, Kulturës dhe Turizmit, shpall thirrjen publike për paraqitjen e projektideve, koncepteve artistike dhe projektpropozimeve për zhvillimin e aktiviteteve artistike dhe kulturore, në kuadër të hartimit të kalendarit artistik dhe kulturor për vitin 2027.
Në këtë kuadër, ftohen **operatorët artistikë dhe kulturorë, subjektet fizike dhe juridike, organizatat, shoqatat dhe individët që ushtrojnë veprimtari në fushën e artit dhe kulturës,** të paraqesin propozimet e tyre, të cilat duhet të përmbushin objektivat e zhvillimit kulturor, promovimit të vlerave artistike, ruajtjes së trashëgimisë dhe pasurimit të jetës kulturore të qytetit dhe të gjithë
territorit të Bashkisë Fier.

Projektpropozimet mund të paraqiten në tri kategoritë e mëposhtme:

1. PROJEKTE TË REJA ARTISTIKE DHE KULTURORE

Në këtë kategori përfshihen **projekte të reja artistike e kulturore**, të cilat propozohen për herë të parë dhe synojnë të bëhen pjesë e kalendarit artistik dhe kulturor të Bashkisë Fier për vitin 2027.
Projektet mund të përfshijnë festivale, koncerte, shfaqje artistike, ekspozita, aktivitete muzikore, teatrore, letrare, vizuale, folklorike, promovuese, si dhe iniciativa të tjera që kontribuojnë në zhvillimin dhe diversifikimin e ofertës kulturore.

2. REALIZIMI ARTISTIK I PROJEKTEVE TRADICIONALE DHE TË PËRVITSHME

Në këtë kategori përfshihen projekte për **konceptimin dhe realizimin artistik të aktiviteteve dhe ngjarjeve kulturore që organizohen tradicionalisht dhe në mënyrë periodike nga Bashkia Fier.**
Propozimet duhet të përmbajnë ide konkrete për programin artistik, përzgjedhjen e artistëve dhe interpretuesve, përmbajtjen krijuese, skenografinë dhe elementet e tjera që lidhen me realizimin artistik të aktiviteteve, duke ruajtur identitetin dhe karakterin e tyre tradicional.

3. REALIZIMI ARTISTIK, ZHVILLIM DHE INOVACIONI I PROJEKTEVE TË VEÇANTA

Në këtë kategori përfshihen projektpropozime **për realizimin artistik, zhvillimin dhe pasurimin e mëtejshëm të aktiviteteve të veçanta,** të konsoliduara dhe me rëndësi të veçantë në kalendarin artistik e kulturor të Bashkisë Fier, konkretisht: "FESTA E GRURIT", "MUZAK FEST".

Projektpropozimet duhet të synojnë rritjen e cilësisë artistike dhe kulturore të këtyre aktiviteteve, përmes koncepteve të reja krijuese, programeve artistike të larmishme, përfshirjes së artistëve dhe grupeve të ndryshme krijuese, si dhe ideve inovative që rrisin vlerën promovuese, turistike dhe kulturore të tyre.

KUSH MUND TË APLIKOJË

Të drejtën për të paraqitur projektpropozime në kuadër të kësaj thirrjeje e kanë:

1. Shoqatat dhe organizatat kulturore e artistike.
2. Personat juridikë që ushtrojnë veprimtari në fushën e artit dhe kulturës.
3. Personat fizikë që ushtrojnë veprimtari në fushën e artit dhe kulturës.

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR

Subjektet e interesuara duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

A. DOKUMENTACIONI I PROJEKTIT

1. Projektidenë/projektpropozimin, me përshkrimin e konceptit, përmbajtjes dhe komponentëve artistikë të projektit.
2. Përbërjen e kastit artistik, duke evidentuar artistët, krijuesit dhe bashkëpunëtorët e përfshirë në realizimin e projektit, si dhe bashkëfinancuesit, nëse ka.
3. Objektivat dhe rezultatet e pritshme të projektit.
4. Programin e propozuar dhe mënyrën e realizimit të tij.
5. Afatin kohor dhe vendin e propozuar për zhvillimin e aktivitetit.
6. Preventivin ose parashikimin financiar orientues të kostove të projektit, duke evidentuar edhe kontributet e mundshme nga burime të tjera financimi.
7. Të dhëna mbi subjektin propozues dhe përvojën e tij në fushën artistike dhe kulturore.

B. DOKUMENTACIONI ADMINISTRATIV I APLIKANTIT

1. Shoqatat dhe organizatat jofitimprurëse

- Formulari i aplikimit;
- Kopje e statutit dhe e vendimit të gjykatës për regjistrimin e subjektit;
- Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT);
- Vërtetim i llogarisë bankare në lekë (ALL);
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore.

2. Personat juridikë (subjekte të regjistruara)

- Formulari i aplikimit;
- Ekstrakt historik ose ekstrakt i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB);
- Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT), nëse nuk pasqyrohet në ekstrakt;
- Vërtetim i llogarisë bankare në lekë (ALL);
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore;
- CV ose portofol i subjektit, që evidenton përvojën në fushën artistike dhe kulturore.

3. Personat fizikë (subjekte të regjistruara)

- Formulari i aplikimit;
- CV profesionale dhe portofol artistik;
- Ekstrakt i Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB);
- Vërtetim i llogarisë bankare në lekë (ALL);
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore.

Afati dhe mënyra e dorëzimit

Projektpropozimet duhet të dorëzohen deri më datë **27.11.2026**, pranë protokollit të Bashkisë Fier.
Në subjektin e komunikimit duhet të përcaktohet qartë kategoria për të cilën paraqitet projektpropozimi.

Shqyrtimi i projektpropozimeve

Projektpropozimet e paraqitura do të administrohen dhe shqyrtohen nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Fier, nëpërmjet Drejtorisë së Artit, Kulturës dhe Turizmit, në funksion të evidentimit të ideve dhe koncepteve artistike, planifikimit të kalendarit kulturor dhe përgatitjes së projektbuxhetit për vitin 2027.

a) Paraqitja e një projektpropozimi në kuadër të kësaj thirrjeje nuk përbën angazhim automatik për financimin apo realizimin e tij.
b) Përzgjedhja dhe financimi i projekteve do të kryhen në përputhje me procedurat përkatëse, kriteret e miratuara, mundësitë buxhetore dhe legjislacionin në fuqi.

Bashkia Fier fton të gjithë krijuesit, artistët dhe operatorët kulturorë të kontribuojnë me ide dhe projekte që pasurojnë jetën artistike e kulturore, promovojnë identitetin e Fierit dhe krijojnë mundësi të reja për zhvillimin kulturor dhe turistik të territorit.

Publikimi dhe transparenca

Kjo thirrje do të publikohet në faqen zyrtare të web-it të Bashkisë Fier, me qëllim garantimin e një pjesëmarrjeje sa më të gjerë, të hapur dhe transparente, duke u krijuar mundësi të gjithë operatorëve artistikë dhe kulturorë të interesuar të njihen me të dhe të paraqesin projektpropozimet e tyre.

Drejtoria e Artit, Kulturës dhe Turizmit